

VENDIM
Nr. 6, datë 13.1.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E
RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 57, pika 2, nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e datës së hyrjes në fuqi të vendimit nr. 53, datë 2.9.2020 “Për disa ndryshime në rregulloren Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, nga data 1 qershor 2021, më datën 1 janar 2022.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko